

Alban Nako

Z. Alban Nako ushtron detyrën e Këshilltarit në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve të Departamentit të Shërbimeve Ligjore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë prej Nëntorit 2021.

Z. Nako është kandidat për gradën shkencore “doktor” me tezë disertacioni: “*Zgjedhje pa demokraci: Mashtrimi elektoral, militantizmi dhe pjesëmarrja në votime 1991-2021*”, pranë Universitetit Epoka në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ai është diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 2015 në programin Master i Shkencave në Shkenca Penale.

Z. Nako ka ushtruar detyrën e Nëpunësit për Uljen e Çështjeve të Prapambetura në Gjykatën e Lartë pranë Kolegjit Penal në funksion të projektit “Drejtësi për të gjithë” të financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit (INL) dhe implementuar nga East West Management Institute, dega Shqipëri.

Botimet e tij më të fundit janë:

1. Jusufi, I., Wüstenberg, R. K., Nako, A., Mulleti, N., Stasa, I., Özcan, S., Barakat, Z., Shkurtaj, G. (2021) An Analysis of Public Discourse on Albania’s Transitional Justice System. In I. Chilwa, *Discourse and Conflict: Analysing Text and Talk of Conflict, Hate and Peace-building*. London: Palgrave Macmillan https://doi.org/10.1007/978-3-030-76485-2_15
2. Pilaca, G. & Nako, A. (2021) Organized crime in Albania: A path dependence perspective. *Czech Journal of Political Science*, 28 (3), 245-273. <https://www.cceol.com/search/article-detail?id=989336>

Kontakt: alban.nako@klp.al